

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: Vehbi Mamaj B.I.; Kab Holding SH.P.K., Rr. Skënderbeu pn, 23000, Suhareke Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	08.07.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **08.07.2024**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: Vehbi Mamaj B.I.; Kab Holding SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: Vehbi Mamaj B.I.; Kab Holding SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **03.07.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: Vehbi Mamaj B.I.; Kab Holding SH.P.K. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE**, me Numër të prokurimit: **623-24-3803-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-038-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **03.07.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **08.07.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit *B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar*, ku kemi cekur:

ARSYETIM:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 20 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, min. 20 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani dhe nënshkrimi i punëtorëve ne atë liste – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, e prezantuar nga **Operatori Ekonomik: Vehbi Mamaj B.I.** është e pa nënshkruar nga Operatori Ekonomik,

Ku dokumenti ne fjale nuk mund te kërkohet ne baze te Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Në ofertën e juaj të dorëzuar, Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, e prezantuar nga **Operatori Ekonomik: Kab Holding SH.P.K.** por e cila listë është e panënshkruar nga punëtor, ku dokumenti në fjale nuk mund të kërkohet në baze të Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: *Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së*

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet të ketë në listën të paktën këtë staf profesional:

2.4. Master ose Bachelor i diplomuar në Menaxhimin e Emergjencave, Master me Një (1) vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar me tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- **Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;**
- **CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);**
- **Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;**
- **Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;**

Sqarimet janë si në vijim:

Në bazë të Formular **B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit**, kemi kërkuar:

Ne ofertën e juaj të dorëzuar, nuk keni prezantuar, dokumentet e kërkuara të Kërkesës Nr. 2, përkatësisht **2.4: Master ose Bachelor i diplomuar në Menaxhimin e Emergjencave, Master me Një (1) vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar me tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit;**

Dhe sipas **Dëshmisë 2** të kërkuar dokumentare:

- **Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;**
- **CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);**
- **Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;**
- **Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;**

Për te mos ra ndesh me Nenin 72 pika 3 i LPP – së i cili e përcakton si në vijim:

Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Si dëshmi për Inxhinieret duhet të ofrohet kontrata dhe lista e pagave nga ATK, ngase ekzistenca ofrimit të para kontratës para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, në këtë rast nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Ju si Operatorë Ekonomik, në sqarimet e dhëna me datë: 02.07.2024:

Dërguar nga : Vehbi Mamaj B.I.	02.07.2024 10:01
Dokumenti për dërgim te AK	
5.Kapaciteti profesional, Master i Menaxhimit te Emergjencave.pdf	02.07.2024 09:59
Hape:	<input type="button" value="Shqip"/>

Keni prezantuar KONTRATË MBI VEPËR, por nuk keni prezantuar lista e pagave nga ATK, ne bazë të Kërkesës tonë për sqarimin e tenderit, dhe prani i Kontratës mbi Vepër, pas hapjes së ofertave është në kundërshtim me Nenin 72 pika 3 të LPP-së

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf teknik

3.2. Një (1) drenazhues i dheut, duhet të jetë i trajnuar në fushën për siguri në vendin e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për siguri dhe shëndet në punë;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- Certifikata përkatëse – Kopje të noterizuar;
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;

Sqarimet janë si në vijim:

Në bazë të Formular B47 Letër Standarde e kërkesës per sqarimin e tenderit, kemi kërkuar:

3.2. Një (1) drenazhues i dheut, duhet të jetë i trajnuar në fushën për siguri në vendin e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për siguri dhe shëndet në punë, keni prezantuar: z. **Astrit Buzhala;**

Sipas **Dëshmisë 3** të kërkuar dokumentare:

- Certifikata përkatëse – Kopje të noterizuar;

Ne ofertën e juaj të prezantuar, Mungon Certifikata për Kërkesë 3.2;

Ju si Operatorë Ekonomik, në sqarimet e dhëna me datë: 02.07.2024:

Dërguar nga : Vehbi Mamaj B.I.	02.07.2024 10:01
Dokumenti për dërgim te AK	
5.Kapaciteti profesional, Drenazhues i Dheut.pdf	02.07.2024 10:00
Hape:	<input type="button" value="Shqip"/>

Keni prezantuar CERTIFIKATË TRAJNIMI nga AQSCERT, për z. Astrit Buzhala, ku ceket: *Mori pjese ne trajnimin me teme: “Kurs Trajnimi për: Sistemet e Drenazhimit sipas ISO DS CEN TR 15128 – 2005”*

Ku ndër të tjera ceket se Trajnim i realizuar ON-LINE,

Datat e trajnimit	01/04/2024	03/04/2024	Ore	24
Vendi i trajnimit	Tirane, Shqiperi		Trajnim i realizuar ON-LINE	
Organizatoret e trajnimit	AQSCERT "Organizëm i Vlerësimit të Konformitetit"			
Datat e lëshimit	03/04/2024		Data e skadences	03/04/2027

Ndërsa në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë është kërkuar: **Duhet të jetë i trajnuar në fushën për siguri në vendin e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për siguri dhe shëndet në punë, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së**

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 1 citoj:

Pretendimi 1: AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka trajtuar të gjitha kompanitë si të barabarta. Arsyetja që e ka shpallur fitues dhe ka favorizuar një OE, edhe pse kriteret e dhënies ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin me të ulët, jo vetëm se nuk e keni marr për bazë, por e keni shkelur nenin 1 të LPP-së Ruajtja e paras publike.

Së dyti lidhur me këtë qështje Neni 1 i LPP-së ju obligon që fondet ti përdorni në mënyrë të drejtë dhe jo ta dëmtoni bugjetin e taksa paguesëve.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 1

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, është i pabazuar

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Sipas **nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës**, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ne bazë të formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, me datë: **03.07.2024**, ju kemi cekur arsyet se tenderi juaj Refuzuar për këto arsye: ***Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), duke cekur Arsyet në Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar;***

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 2 citoj:

Pretendimi 2. Sa i përket arystimit të AK-së ne vendimin se ne si OE kemi dorëzuar listen e pa nënshkruar, ju kujtojmë se lista e dorëuar nga OE Vehbi Mamaj B.I. është vulosur nga kompania dhe kjo dëshmon mjaftushëm origjinalitetin dhe përmbajtjen e dokumentit. Gjithashtu ju kujtojmë se ne si lider në këtë aktivitet të prokurimit i mbulojmë nr e punëtorve të kërkuar andaj edhe pse pretendimi juaj kinse lista e parterit e koncerisumit Kab Holding sh.p.k. nuk është e punuar siç kërkohet, ne konisederojmë se kjo është vetëm tendencë për të na eliminuar sepse këto janë devijme të vogal siç e shpjegon neni 59 i LPP-së dhe 45.19 i udhëzuesit.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 2

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, është i pabazuar

Ne bazë të formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, me datë: **03.07.2024**, ju kemi cekur arsyet se tenderi juaj Refuzuar për këto arsye:

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, e prezantuar nga **Operatori Ekonomik: Vehbi Mamaj B.I.** është e pa nënshkruar nga **Operatori Ekonomik**, (Shih foton e bashkangjitur):



20.05.2024

Ku dokumenti ne fjale nuk mund te kërkohet ne baze te Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Në ofertën e juaj të dorëzuar, Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, e prezantuar nga Operatori Ekonomik: Kab Holding SH.P.K. por e cila listë është e panënshkruar nga punëtor, (Shih foton e bashkangjitur):



LISTA E STAFIT

Nr	Emri Mbiemri	Mosha	Profesioni	Eksperienca	Pozita ne Kompani
1	Idriz Seferaj	43	ING I Ndertimtaris-Konstruktiv	18	Drejtor
2	Behar Seferaj	27	Ekonomist	6	Menaxher
3	Muharrem Kabashi	48	Menaxher	20	Menaxher Prodhimi
4	Ilir Hoxha	31	Ekonomist	8	Ekonomist
5	Rexhep Kolgeci	52	Saldues	31	Saldues
6	Luan Baraliu	54	Punetor	35	Punetor
7	Mem Memaj	42	Shofer	20	Shofer
8	Daut Hasnaj	32	ING I Ndertimtaris-Konstruktiv	10	Menaxher
9	Mehmet Selimaj	42	Punetor	18	Punetor
10	Fitim Fetaj	39	Punetor	14	Punetor
11	Endrit Gashi	24	Punetor	5	Punetor
12	Remzi Aliaj	45	Punetor	21	Shofer
13	Elis Kotorri	24	Punetor	5	Punetor



Ku dokumenti ne fjale nuk mund te kërkohet ne baze te Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së
Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 3 citoj:

Pretendimi 3.

Sa i përket kërkesës Nr. 2, përkatësisht 2.4 në bazë të kërkesës së AK-së për sqarime ne kemi dorëzuar një inxhiner me Master për Menaxhimin e Emergjencave, ku duke i'u referuar dosjes së tenderit dhe kemi bërë një Kontratë mbi Vepër për këtë projekt, ku data është bërë me datën e dorëzimit të ofertave, dhe ky informacion është bërë para datës së dorëzimit të ofertave dhe mund të të verifikohet në mënyrë objektive sepse është e nënshkruar nga të dyja palët.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 3

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, është i pabazuar

Ne bazë të formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, me datë: **03.07.2024**, ju kemi cekur arsyet se tenderi juaj Refuzuar për këto arsye:

Sqarimet janë si në vijim:

Në bazë të Formular **B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit**, kemi kërkuar:

Ne ofertën e juaj të dorëzuar, nuk keni prezantuar, dokumentet e kërkuara të Kërkesës Nr. 2, përkatësisht 2.4: **Master ose Bachelor i diplomuar në Menaxhimin e Emergjencave, Master me Një (1) vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar me tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit;**

Dhe sipas **Dëshmisë 2** të kërkuar dokumentare:

- **Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;**
- **CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);**
- **Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;**
- **Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;**

Për te mos ra ndesh me Nenin 72 pika 3 i LPP – së i cili e përcakton si në vijim:

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Si dëshmi për Inxhinieret duhet te ofrohet kontrata dhe lista e pagave nga ATK, ngase ekzistenca ofrimit të para kontratës para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, në këtë rast nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Ju si Operatorë Ekonomik, në sqarimet e dhëna me datë: 02.07.2024:

Dërguar nga : Vehbi Mamaj B.I.	02.07.2024 10:01
Dokumenti për dërgim te AK	
5.Kapaciteti profesional, Master i Menaxhimit te Emergjencave.pdf	02.07.2024 09:59
Hape:	<input type="button" value="Shqip"/>

Keni prezantuar KONTRATË MBI VEPËR, por nuk keni prezantuar lista e pagave nga ATK, ne bazë të Kërkesës tonë për sqarimin e tenderit, dhe prani i Kontratës mbi Vepër, pas hapjes së ofertave është në kundërshtim me Nenin 72 pika 3 të LPP-së i cili e përcakton si në vijim:

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Si dëshmi për Inxhinieret duhet te ofrohet kontrata dhe lista e pagave nga ATK, ngase ekzistenca ofrimit të para kontratës para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, në këtë rast nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 4 citoj:

Pretendimi 4. Sa i përket kërkesës 3.2 për një drenazhës të dheut dhe kemi dorëzuar z. Astrit Buzhala i cili është ti çertifikuar sipas kërkesës se dosjes së tenderit. Më poshtë i keni edhe dëshmit .

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 4

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, është i pabazuar

Ne bazë të formularit B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, me datë: 03.07.2024, ju kemi cekur arsyet se tenderi juaj Refuzuar për këto arsye:

Në bazë të Formular B47 Letër Standarde e kërkesës per sqarimin e tenderit, kemi kërkuar:

3.2. Një (1) drenazhues i dheut, duhet të jetë i trajnuar në fushën për siguri në vendin e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për siguri dhe shëndet në punë, keni prezantuar: z. Astrit Buzhala;

Sipas **Dëshmisë 3** të kërkuar dokumentare:

• **Certifikata përkatëse – Kopje të noterizuar;**

Ne ofertën e juaj të prezantuar, Mungon Certifikata për Kërkesë 3.2;

Ju si Operatorë Ekonomik, në sqarimet e dhëna me datë: 02.07.2024:

Dërguar nga : Vehbi Mamaj B.I.

02.07.2024 10:01

Dokumenti për dërgim te AK

5.Kapaciteti profesional, Drenazhues i Dheut.pdf

02.07.2024 10:00

Hape:

Shqip

Keni prezantuar CERTIFIKATË TRAJNIMI nga AQSCERT, për z. Astrit Buzhala, ku ceket:
Mori pjese ne trajnimin me teme: “Kurs Trajnimi për: Sistemet e Drenazhimit sipas ISO DS CEN TR 15128 – 2005”

Ku ndër të tjera ceket se Trajnim i realizuar ON-LINE,

Datat e trajnimit:	01/04/2024	03/04/2024	Ore	24
Vendi i trajnimit:	Tirane, Shqiperi Trajnim i realizuar ON-LINE			
Organizatoret e trajnimit:	AQSCERT "Organizëm i Vlerësimit të Konformitetit"			
Datat e lëshimit:	03/04/2024	Data e skadences	03/04/2027	

Ndërsa në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë është kërkuar: Duhet të jetë i trajnuar në fushën për siguri në vendin e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për siguri dhe shëndet në punë, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit